



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: HISTORIA E QYTETËRIMEVE

Pedagogu: Prof. Asoc. Dr. Artan Puto
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: III/I

EKSTRAKT

Lënda e “Qytetërimi shqiptar » synon t’u japë studentëve te drejtimit Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore disa njohuri bazë për konceptin e « qytetërimin shqiptar ». Fillimisht do të trajtohet ai nga pikëpamja teorike dhe pastaj do të synohet që koncepti i « qytetërimin shqiptar » të shtjelohet edhe si ligjërime dhe i lidhur ngushtë me atë që shihet si « identiteti kombëtar ». Mendojmë se një qasje e tillë do t’u japë studentëve mundësinë ta shohin qytetërimin shqiptar si një fenomen të lëvizshëm, që nuk është statik, por që është gjithmonë në një proces formulimi dhe riformulimi. Nga ana tjetër, një qasje e tillë do të mund të tregojë se ajo që shpesh përfytyrohet si « qytetërim shqiptar » i dhënë një herë e përgjithmonë është në të vërtetë produkt i shtresëzimeve kulturore të ndryshme që vijnë përgjatë shekujve. Një vend të rëndësishëm do të zërë në leksione edhe diskutimi mbi vendin e « qytetërimin shqiptar », është ai në « Lindje » apo në « Perëndim ».

TEMAT:

LEKSION 1. Përkufizimi i nocionit qytetërim. Qytetërimi dhe kultura. Qytetërimi është hapësirë. Qytetërimi është shoqëri.

LEKSION 2. Qytetërimi është ekonomi. Qytetërimi është mendësi kolektive. Qytetërimet janë vazhdimësi. Qytetërimet në strukturat e tyre. Histori dhe qytetërim.

LEKSION 3. Përkufizimi i qytetërimeve të hershme

LEKSION 4. Racionalizmi dhe relativizmi. Romantizmi. Studimet komparative të qytetërimeve të hershme.

LEKSION 5. Banorët e lashtë të Shqipërisë. Pellazgët dhe ilirët. Organizimi shoqëror i hershëm i ilirëve. Kolonitë helene në brigjet e Shqipërisë.

LEKSION 6. Shtetet ilire. Luftrat iliro-romake. Qytetërimi antik ilir. Ilirët nën sundimin romak. Përhapja e krishtëritimit në viset shqiptare.

LEKSION 7. Fillimet e sundimit bizantin, trojet shqiptare gjatë shekujve VII-VIII. Qytetërimi i hershëm shqiptar.

LEKSION 8. Qytetet dhe jeta qytetare në shek. XIV. Arkitektura dhe piktura mesjetare. Letërsia gojore mesjetare. (K. Frashëri) (duhet parë edhe Arbëria venedike e Schmitt)

LEKSION 9. Themelet kulturore-historike: populli dhe poezia e tij. Emri i popullit. Fuqi centrifugale në historinë dhe karakterin e popullit shqiptar.

LEKSION 10. Shqipëria midis Perëndimit dhe Lindjes. Karakteri konservativ i zonave malësore të anëve.

LEKSION 11. Njësia e kombit dhe shpirti i kombit. Poezia popullore.

LEKSION 12. Literatura. Romantizmi në Evropën Lindore dhe Juglindore dhe në literaturën shqiptare

LEKSION 13. Dalja e gjuhëve modern ballkanike. Gjuha si faktor i identitetit kombëtar në Ballkan.

LEKSION 14. Historia e alfabetit shqiptar, një rast kompleks kulturor dhe i zhvillimit politik.

LEKSION 15. Çfarë është identiteti kombëtar. Identiteti shqiptar është evropian apo i përbërë?

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranishë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

FERNAND BRAUDEL, "GRAMATIKA E QYTETERIMEVE", SHBLK, TIRANE 2002.

HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR, VOL. 1, BOTIMET TOENA, TIRANE 2002

EQREM CABEJ, "SHQIPTARET MIDISLINDJES DHE PERENDIMIT", BOTIMET MCM, TIRANE 1994

KRISTO FRASHERI, "IDENTITETI KOMBETAR SHQIPTAR DHE CESHTJE TE TJERA", EDISUD, TIRANE 2006

BARDHYL DEMIRAJ, "SHQIPTAR", SHTEPIA BOTUESE NAIMI, TIRANE 2010

ISMAIL KADARE, "POSHTERIMI NE BALLKAN", BOTIME ONUFRI, TIRANE 2004

ISMAIL KADARE, "IDENTITETI EVROPIAN I SHQIPTAREVE", BOTIME ONUFRI, TIRANE 2006

REXHEP QOSJA, "IDEOLOGJIA E SHPERBERJES", BOTIMET TOENA, TIRANE 2006

REXHEP QOSJA, "REALITETI I SHPERFILLUR", BOTIMET TOENA, TIRANE 2006

ENIS SULSTAROVA, "JAM EVROPE", LOGOS-A, SHKUP-TIRANE 2012

ENIS SULSTAROVA, "ARRATISJE NGA LINDJA", PIKA PA SIPERFAQE, TIRANE 2013